



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 131, Datë 21.05.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË
ERE-S NR. 139, DATË 14.04.2023, “MBI MIRATIMIN E KUFIJVE MINIMALË DHE
MAKSIMALË TË LEJUAR TË ÇMIMIT PËR TREGUN E DITËS NË AVANCË”**

Në zbatim të neneve 16, 18, pika 1, gërma “a” dhe “dh”; 19, gërma “a”; 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 3.5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Rregullat e tregut të energjisë elektrike (Kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes), të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuara; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 957/5 prot., datë 18.05.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme “Mbi fillimin e procedurës për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.04.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 139, datë 14.04.2023, vendosi miratimin e Kufijve Minimalë dhe Maksimalë të Lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë për operimin e Jo-Bashkimit të Tregjeve, si vijon: - Kufiri Maksimal i Lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë: + 900 €/MWh. - Kufiri Minimal i Lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë: 0 €/MWh.
- Në vijim të operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike “ALPEX” sh.a. në tregun e ditës në avancë janë aplikuar kufijtë e sipërcituar për operimin e tregut në zonën e ofertimit në Shqipëri.
- “ALPEX” sh.a., me shkresën nr. 170 prot., datë 18.03.2026, protokolluar në ERE me nr. 957 prot., datë 24.03.2026, ka paraqitur propozimin për ndryshimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.04.2023, duke propozuar që Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë të mbetet në vlerën +900 €/MWh, ndërsa Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë të ndryshojë nga 0 €/MWh në -50 €/MWh.
- Në vijim të kësaj kërkesë, ERE, me shkresën nr. 957/3 prot., datë 09.04.2026, i kërkoi "ALPEX" sh.a. të depozitojë argumentim të detajuar lidhur me vlerën e propozuar prej -50 €/MWh si kufi minimal të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë.

- “ALPEX” sh.a., me shkresën nr. 217/1 prot., datë 24.04.2026, protokolluar në ERE me nr. 957/4 prot., datë 29.04.2026, ka depozituar argumentimet plotësuese duke vënë në dukje se: (i) në tregun european, në nivel SDAC, prej muajit janar 2025 është eliminuar plotësisht ankandi i dytë i cili aplikohet nga disa bursa; (ii) çmimet negative janë praktikë integrale e formimit të lirë të çmimit klerues në tregjet evropiane të energjisë elektrike; (iii) urdhërporositë me çmime negative kanë filluar të evidentohen në “ALPEX” sh.a. që në vitin 2024 dhe janë në rritje.
- Në ditën e tregtimit 05.05.2024 për ditën e lëvrimit 06.05.2024 janë regjistruar katër njësi kohore tregu (MTU) me çmim klerues të Tregut të Ditës në Avancë -20 €/MWh, ndërsa në ditën e tregtimit 06.05.2024 për ditën e lëvrimit 07.05.2024 janë regjistruar dy njësi kohore tregu (MTU) me çmim klerues -500 €/MWh.
- Gjatë periudhës nga muaji janar 2026 deri më 18 prill 2026 janë regjistruar 13 (trembëdhjetë) raste të arritjes së kufirit minimal të lejuar të çmimit të tregut të ditës në avancë prej 0 €/MWh dhe në asnjë prej këtyre rasteve anëtarët e bursës nuk kanë ndryshuar ofertat e tyre gjatë aktivizimit të ankandit të dytë, duke treguar se mekanizmi i përdorur nuk ka ndikuar në arritjen e objektivit të tij.
- Dispozita B.2.3.1 e Procedurës së Tregtimit të “Rregullave të tregut të energjisë elektrike” përcakton se procedura për një Ankand të Dytë mundësohet nga ALPEX-i në rastet kur çmimi klerues i tregut arrin ose kalon kufijtë minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë.
- Volumi total i tregtuar nga “ALPEX” sh.a. për vitin 2025 në Tregun e Ditës në Avancë në të dyja zonat e ofertimit arriti vlerën 1,641,291 MWh, duke shënuar një rritje prej rreth 39% krahasuar me vitin 2024, si dëshmi e zgjerimit dhe maturimit progresiv të tregut.
- Në datën 07 Shkurt 2025, "ALPEX" sh.a. është pranuar si vëzhgues në SDAC (Single Day-Ahead Coupling) dhe anëtarësimi i plotë kërkon, ndër të tjera, harmonizimin gradual me praktikatat e tregut european, përfshirë pranimin e çmimeve negative.
- SEEPEX, bursa e energjisë në Serbi, ka filluar aplikimin e çmimeve negative si në tregun e ditës në avancë ashtu edhe në tregun brenda të njëjtës ditë që prej fillimit të muajit maj 2026, duke konfirmuar trendin rajonal drejt liberalizimit të plotë të formimit të çmimit.
- Lidhur me shtrirjen gjeografike të aplikimit të këtyre kufijve, “ALPEX” sh.a. ka vlerësuar se, në kushtet aktuale të operimit si treg i bashkuar ndërmjet zonave të ofertimit Shqipëri dhe Kosovë, kufijtë minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë do të aplikohen në të dyja zonat e ofertimit dhe për këtë qëllim është njoftuar edhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) në Kosovë më datë 16.04.2026.
- Rishikimi i propozuar mbështetet metodologjikisht në Nenin 41(1) të Rregullores së Komisionit Evropian nr. 2015/1222, datë 24.07.2015 “Për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Kongjestionëve”, si dhe në praktikatat e ndjekura nga bursat evropiane të energjisë elektrike.

- Rishikimi i Kufirit Minimal të Lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë nga 0 €/MWh në -50 €/MWh paraqitet si një propozim që meriton shqyrtim të mëtejshëm në kuadër të zhvillimeve të tregut dhe përafrimit gradual me praktikat rajonale dhe europiane të tregtimit të energjisë elektrike. Për këtë arsye vlerësohet fillimi i procedurës, duke iu nënshtruar procesit të konsultimit publik me palët e interesit, në përputhje me rregullat e ERE-s për konsultimin e akteve rregullatore, përpara se bordi i ERE-s të shprehet me vendim përfundimtar mbi ndryshimin e propozuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 139/2023 lidhur me Kufirin Minimal të Lejuar të çmimit për Tregun e Ditës në Avancë të propozuar si më poshtë nga Alpex:
-Kufiri Minimal i Lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë te behet nga 0 €/MWh në -50 €/MWh
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Zhvillimit të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e tjera të interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI